



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER  
ORGANI QENDROR BLERËS

Nr. \_\_\_\_/\_\_\_\_Prot.

Fier, më 06.11.2024

**Lënda:** Formulari i njoftimit paraprak të fituesit për procedurën me objekt “Blerje skrepa, eskavator dhe buldozer”, për nevoja të Ndermarrjeve dhe Drejtorive vartese të Bashkisë Fier”, me burim financimi nga buxheti i Shtetit, i Bashkisë Fier dhe i Ndermarrjes së Sherbimeve Publike Fier.

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK  
TIRANË  
(për botim)

Shtojca 10

Bashkia Fier

**Data:** 06.11.2024

**Drejtuar:** Operatorit ekonomik TEKNOXGROUP SHQIPERI SHPK,

**Adresa:** Tirane Vore VORE Fshati Mucaj - Vore, Rruga Nacionale Tirane - Durrës, Km 16,

**NUIS:** J61926006P

\* \* \*

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur me mjete elektronike - mbi kufirin e lartë monetar.

**Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-19518-09-13-2024.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje skrepa, eskavator dhe buldozer”, për nevoja të Ndermarrjeve dhe Drejtorive vartese të Bashkisë Fier”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratave prej **72 566 666 .67** (shtatedhjetë e dy milion e pesëqind e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtedhjetë e gjashtë pike gjashtedhjetë e shtate) **lekë pa TVSH ose fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 13.09.2024): 729 533.19** (shtatëqind e njëzetë e nentë mijë e pesëqind e tridhjetë e tre pikë nentëmbëdhjetë) **Euro**, me burim financimi nga buxheti i Shtetit, i Bashkisë Fier dhe i Ndermarrjes së Sherbimeve Publike Fier, në përputhje me preventivin, sasin, specifikimet teknike dhe kushtet e përcaktuara në DST.

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës:

**- Jo më vonë se 60 ditë nga nënshkrimi i kontratës.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [23 Shtator 2024], [Numri 63].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **PO**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik **TEKNOXGROUP SHQIPERI SHPK me NUIS J61926006P**. Vlera totale sipas shtojcës sipas formularit të ofertës paraqitur në SPE është 54 502 520 (pesedhjetë e kater milion e pesëqind e dy mijë e pesëqind e njezet) lekë pa tvsh dhe 65 403 024 (gjashtedhjetë e pese milion e katerqind e tre mijë e njezet e kater) lekë me tvsh. - afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
2. Operatori ekonomik **ARTEO 2018 SHPK me NUIS L82523203F**. Vlera totale sipas shtojcës sipas formularit të ofertës paraqitur në SPE është 59 850 000 (pesedhjetë e nente milion e tetëqind e pesedhjetë mijë) lekë pa tvsh dhe 71 820 000 (shtatedhjetë e nje milion e teteqind e njezet mijë) lekë me tvsh. - afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
3. Operatori ekonomik **ELI SHPK me numër NUIS K71920502I**. Vlera totale sipas shtojcës sipas formularit të ofertës paraqitur në SPE është 65,000,000 (gjashtedhjetë e pese milion); lekë pa tvsh dhe 78,000,000 (shtatedhjet e tete milion); lekë me tvsh. - afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
4. Operatori ekonomik **MEKTRIN MOTORS SHPK me NUIS K51408501P**. Vlera totale sipas shtojcës sipas formularit të ofertës paraqitur në SPE është 55 855 200 (pesedhjetë e pese milion e e tetëqind e pesedhjetë e pese mijë e dyqind) lekë pa tvsh dhe 66 026 240 (gjashtedhjetë e gjashte milion e njezet e gjashte mijë e dyqind e dyzete) lekë me tvsh. - afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
5. Operatori ekonomik **START CO SHPK me NUIS L11614001S**. Vlera totale sipas shtojcës sipas formularit të ofertës paraqitur në SPE është 62'060'000 (gjashtëdhjetë e dymilion e gjashtëdhjetë mijë); lekë pa tvsh dhe 74'472'000 (shtatëdhjetë e katëmilion e katëqind e shtatëdhjet e dymijë);. - afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
6. Operatori ekonomik **VIBTIS SHPK me NUIS L02103503S**. Vlera totale sipas shtojcës sipas formularit të ofertës paraqitur në SPE është 64 584 330 (gjashtedhjetë e kater milion e pesëqind e tetedhjetë e kater mijë e treqind e tridhjetë) lekë pa tvsh dhe 77 501 196 (shtatedhjetë e shtate milion e pesëqind e nje mijë e njeqind e nentedhjetë e gjashte) lekë me tvsh. - afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

\*\*\*\*\*

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës **ARTEO 2018 SHPK me NUIS L82523203F**, konstatoi mangësit si më poshtë:

**1. Referuar Shtojcës 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.3, përcaktohet se:**

*”Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalog/katalogje të prodhuesit ose fragmente të katalogut / eve të prodhuesit ose skede teknike të prodhuesit, që përmbajnë të dhëna dhe specifikime teknike të ketyre mallrave objekt prokurimi, të cilat duhet të jenë në përputhje me karakteristikat apo specifikimet teknike të kerkuara nga autoriteti kontraktor, për mallrat objekt prokurimi.”*

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur:

➤ **Për mjetin «Eskavator (Skrep) me goma” sipas Shtojcës 6 të DST-së:**

- Skedë teknike me logo “XCMG”, ku pas krahasimit të të dhënave dhe specifikimeve teknike të pasqyruara në katalog, rezulton se nuk ka të pasqyruara të dhëna për:
  - Karburanti (Naftë)
  - Trasmisioni (Manual ose Automatik)
  - Kollona e pasme (Teleskopike)
  - Sistemi i komandimit (Manual ose Automatik)
  - Secili mjet të jete i pajisur me dy kova germimi me keto permasa (Nje mjet te kete nje kove me permasa 55 ose 60 ose 65 cm dhe nje kove 35 ose 40 ose 45 Nje mjet te kete nje kove permasa 55 ose 60 ose 65 cm dhe nje kove 25 ose 30 ose 35cm)
  - Me goma , dy gomat e perparme te vogla , dy te pasmet te medha
  - Skrepat te kene te instaluar sistemin standart te vendosjes se çekiçit dhe turjeles shpuese

➤ **Për mjetin «Mini Eskavator me zinxhir hekuri për punime germimi” sipas Shtojcës 6 të DST-së:**

- Skedë teknike me logon “XCMG”, ku pas krahasimit të të dhënave dhe specifikimeve teknike të pasqyruara në katalog, rezulton se nuk ka të pasqyruara të dhëna për:
  - Karburanti (Naftë)
  - Sistemi i hapjes së kraheve (Hidraulike)
  - Pesha (Min 8 ton)
  - Te jete i pajisur me dy kova, nje me thike për pastrim kanalesh jo me pak se 0.3 m3 dhe nje me dhembë për germimjo me pak se 0.25 m3 , si dhe të kete thiken e perparme për sistemim dherash.

➤ **Për mjetin «Traktor (Bulldozer) me zinxhir” sipas Shtojcës 6 të DST-së:**

- Skedë teknike me logon “XCMG”, ku pas krahasimit të të dhënave dhe specifikimeve teknike të pasqyruara në katalog, rezulton se nuk ka të pasqyruara të dhëna për:
  - Karburanti (Naftë)
  - Gjeresia e thikes (Min3 m)
  - Thika e perpareme e levizshme vertikalisht dhe horizontalisht (nuk është e nevojshme thika e pasme)

2. “|b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8”

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik ARTEO 2018 SHPK, rezulton se ky formular nuk është sipas shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” i miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik me vendimin nr. 10, datë 05.10.2022 dhe i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit.

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, oferta e **ARTEO 2018 SHPK me NUIS L82523203F** skualifikohet.

2. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës **ELI SHPK me numër NUIS K71920502I**, konstatoi mangësit si më poshtë:

3. Referuar Shtojcës 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.2, përcaktohet se:

*“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, për mallrat (mjetet) objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, duhet të provohet edhe lidhja midis Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar.”*

Nga ana e OE në përmbushje të këtij kriteri është ngarkuar në SPE:

Dokumenti me emertimin “9- Autorizim Distributori Korkovado Buldozer”, nga shoqëria ELI SHPK, me lëndë “Autorizim distributori”, në përmbajtje të së cilit ndër të tjera citohet:

*“Ne "KORKOVADO d.o.o", si një shoqëri përgjegjëse, me adresë: Ratarski put 14a, 11080 Zemun, Beograd, që jemi distributori i autorizuar nga prodhuesi "XCMG", autorizojnë shoqërinë "ELI" sh.p.k. me adresë në Vlashaj, Maminas, Z. K. 3796, N. P 343/15, Durres, NIPT K71920502I, për të paraqitur një ofertë për pajisjen "BULLDOZER XCMG D260" për procedurën e prokurimit ”*

*Blerje skrepa, eskavator dhe buldozer", për nevoja të Ndermarrjeve dhe Drejtorive vartese te Bashkise Fier", ..."*

Pra sa më sipër, referuar përmbajtjes së këtij dokumenti, fakti që «KORKOVADO d.o.o» është distributor i «XCMG» deklarohet nga «KORKOVADO d.o.o» por jo nga vet prodhuesi «XCMG».

Në këto kushte, KVO vlerëson se dokumenti me emertimin “9- \_Autorizim\_Distributori\_Korkovado\_Buldozer”, i ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.2 të Shtojcës 7 të DST-së.

#### **4. Referuar Shtojcës 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.3, përcaktohet se:**

*” Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalog/katalogje të prodhuesit ose fragmente të katalogut/eve te prodhuesit ose skede teknike te prodhuesit, qe permbajne te dhena dhe specifikime teknike te ketyre mallrave objekt prokurimi, te cilat duhet te jene ne perputhje me karakteristikat apo specifikimet teknike te kerkuara nga autoriteti kontraktor, per mallrat objekt prokurimi..”*

Në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik për mjetin «Traktor (Bulldozer) me zinxhir» sipas Shtojcës 6 të DST-së, ka paraqitur katalog për mjetin “XCMG D260 BULDOZER”, ku pas verifikimit të kryer rezulton se nuk ka të dhëna për lëvizshmërinë vertikalisht dhe horizontalisht të thikës së përparme e përcaktuara në specifikimet teknike të hedhura në SPE nga AK (Shtojca 5), ku përkatësisht në pikën 6 kërkohet:

*“6. Thika e perpareme e levizshme vertikalisht dhe horizontalisht (nuk eshte e nevojshme thika e pasme)”.*

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, oferta e **ELI SHPK me numër NUIS K71920502I** skualifikohet.

3.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës **MEKTRIN MOTORS SHPK me NUIS K51408501P**, konstatoi mangësit si më poshtë:

1. Referuar Shtojcës 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.2, përcaktohet se:

*“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, për mallrat (mjetet) objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, duhet të provohet edhe lidhja midis Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar.”*

Nga ana e O.E në përmbushje të këtij kriteri është ngarkuar në SPE:

Dokumenti me emertimin “2-3\_Autorizim\_Prodhuesi-Distributori\_JCB\_per\_Mektrin\_Motors”, nga shoqëria MEKTRIN MOTORS SHPK, datë 24.10.2024, në përmbajtje të së cilit ndër të tjera citohet:

*“ JCB Sales Ltd, Lakeside Works, Rocester, Staffordshire, ST14 5JP, United Kingdom of Great Britain & Northern Ireland (Company Reg No. 0792807) (JCB), acting as selling agent for all machines produced by JCB Group manufacturing companies, hereby confirms that our representative dealer for Grëce – Unitrack S.A, Athens, 18th km E.O., EO Athinon Korinthou, Aspropirgos, 193 00, Republic of Grëce – are submitting a quotation, on their own behalf and at their own risk, for the above Ref. for two (2) JCB 3CX PLUS backhoe loaders and one (1) JCB 85Z-2 mini excavator with stël tracks, through the company Mektrin Motors, Xhafzotaj, Autostrada Durres-Tirane KM.6, Republic of Albania (VAT No. K51408501P), authorized by Unitrack S.A for that purpose.*

*This document is valid in the case of postponement or repetition of this procedure., ...”*

Pra sa më sipër, referuar përmbajtjes së këtij dokumenti, fakti që ”Unitrack S.A, Athens” është distributor i «JCB Group» deklarohet nga «JCB Group», gjithashtu dhe që ”Mektrin Motors” do të furnizohet me mjetet nga ”Unitrack S.A, Athens” deklarohet nga «JCB Group” dhe jo nga «Unitrack S.A, Athens”. Përsa më lartë, provohet lidhja midis «Unitrack S.A, Athens” dhe «JCB Group”, por mungon dokumenti që provon lidhjen midis “Mektrin Motors” dhe «Unitrack S.A, Athens”.

Në këto kushte, KVO vlerëson se dokumenti me emertimin “2-3\_Autorizim\_Prodhuesi-Distributori\_JCB\_per\_Mektrin\_Motors”, i ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.2 të Shtojcës 7 të DST-së.

## **2. Referuar Shtojcës 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.3, përcaktohet se:**

*”Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalog/katalogje të prodhuesit ose fragmente të katalogut / eve të prodhuesit ose skede teknike të prodhuesit, që përmbajnë të dhëna dhe specifikime teknike të ketyre mallrave objekt prokurimi, të cilat duhet të jenë në përputhje me karakteristikat apo specifikimet teknike të kerkuara nga autoriteti kontraktor, për mallrat objekt prokurimi.”*



Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik për mjetin «Mini Eskavator me zinxhir hekuri per punime germimi» sipas Shtojcës 6 të DST-së ka paraqitur katalog me logon “JCB”.

Në lidhje me pikën 8 të specifikimeve teknike (shtojca 5) të DST-së, kërkohet:

*“Te jete i pajisur me dy kova, nje me thike per pastrim kanalesh jo me pak se 0.3 m3 dhe nje me dhembe per germim jo me pak se 0.25 m3, si dhe te kete thiken e perparme per sistemim dherash.”*

Nga verifikimi i kryer në katalogun e ngarkuar në SPE nga OE, në asnjë nga tabelat e specifikimeve teknike nuk ka të dhëna për kapacitetin e kovave të kërkuara nga AK për këtë mjet.

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, oferta e MEKTRIN MOTORS SHPK me NUIS K51408501P skualifikohet.

4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës **START CO SHPK me NUIS L11614001S**, konstatoi mangësit si më poshtë:

**Referuar Shtojcës 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.3, përcaktohet se:**

*”Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalog/katalogje të prodhuesit ose fragmente të katalogut / eve te prodhuesit ose skede teknike te prodhuesit, qe permbajne te dhena dhe specifikime teknike te ketyre mallrave objekt prokurimi, te cilat duhet te jene ne perputhje me karakteristikat apo specifikimet teknike te kerkuara nga autoriteti kontraktor, per mallrat objekt prokurimi.”*

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur:

➤ **Për mjetin «Mini Eskavator me zinxhir hekuri per punime germimi» sipas Shtojcës 6 të DST-së:**

- Katalog, ku pas krahasimit të të dhënave dhe specifikimeve teknike të pasqyruara në të rezulton se modeli i pasqyruar është me zinxhir gome dhe jo zinxhir hekuri siç është kërkuar në specifikimet teknike të hedhura në SPE nga AK (Shtojca 5).

➤ **Për mjetin «Traktor (Bulldozer) me zinxhir» sipas Shtojcës 6 të DST-së:**

- Katalog, ku pas krahasimit të të dhënave dhe specifikimeve teknike të pasqyruara në të, rezulton se fuqia motorike është 126 kw dhe jo min 127 kw siç është kërkuar në specifikimet teknike të hedhura në SPE nga AK (Shtojca 5).

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit", oferta e **START CO SHPK me NUIS L11614001S** skualifikohet.

5. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës **VIBTIS SHPK me NUIS L02103503S**, konstatoi mangësit si më poshtë:

1. Referuar Shtojcës 7, "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 2.1.a, kërkohet:  
"1.a. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3**"

Nga verifikimi i Formularit të Sigurimit të Ofertës nr. BND0021962, datë 29.10.2024, lëshuar nga INTERSIG, ngarkuar në S.P.E nga operatori ekonomik VIBTIS SHPK, rezulton se shuma e pasqyruar është në vlerën prej **1 431 333.33** lekë, ndërkohë që në DST, publikuar në SPE, shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është në vlerën prej **1,451,333.33 Lekë**

2. Referuar Shtojcës 7, "Kriteret e veçanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", në pikën **2.3.3**, përcaktohet se:

"Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalog/katalogje të prodhuesit ose fragmente të katalogut / eve të prodhuesit ose skede teknike të prodhuesit, që përmbajnë të dhëna dhe specifikime teknike të ketyre mallrave objekt prokurimi, të cilat duhet të jenë në përputhje me karakteristikat apo specifikimet teknike të kerkuara nga autoriteti kontraktor, për mallrat objekt prokurimi."

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik për mjetin «Eskavator (Skrep) me goma» sipas Shtojcës 6 të DST-së, ka paraqitur «Skedë konfigurimi & Katalog\_MST "MST", ku rezulton se nuk ka informacion nëse Skrepat kanë të instaluar sistemin standart të vendosjes së çekiçit dhe turjelës shpuese (sipas Shtojcës 5 të DST-së).



Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 , "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”*, oferta e **VIBTIS SHPK me NUIS L02103503S** skualifikohet.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik TEKNOXGROUP SHQIPERI SHPK, me NUIS **J61926006P** , me adrese: Tirane Vore VORE Fshati Mucaj - Vore, Rruga Nacionale Tirane - Durres, Km 16, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **54 502 520** (pesedhjetë e kater milion e pesëqind e dy mijë e peseqind e njezet) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

### **ZYRTARI I AUTORIZUAR**

**Zv.Kryetari**

---

**Andius OLLDASHI**